

Ese : "Krimet naziste ndaj shqiptareve"

Historia na ka mësuar shumë rreth vetes. Në përgjigjësi rreth qënies njerzore: reagjimet e saj, synimet, ndjesitë por edhe rreth gabimeve, urrejtjes dhe keqkuptimeve të saj. Në fillimet e krijimit të historisë njeriu ishte një qenie primitive por me kalimin e kohës ajo u zhvillua duke mësuar shumë e më shumë rreth shkencës, astronomisë, matematikës, filozofisë dhe fesë. . Pra, secili vendosi të ndjekë mënyrën e arsyesimit të tij, çfarë ai beson. Por, nuk duhet të harrojmë se në fund të gjithë jemi thjesht njerëz.

Siç thashë, historia na ka mësuar shumë. Ma ka mësuar për ngritjet e njerëzimit por edhe rëniet e tij. Pjesa e rënies është kur egoizmi dhe inati kryesojnë mbi arsyen dhe të drejtën. Kemi shumë shembuj, fatkeqësisht, të këtyre akteve, si: skavërimi, kolonizimi, gjenocidet, luftërat etj.

Por një pjesë të rëndësishme në historinë e luftërave e zë lufta e dytë botërore. Ishe një nga luftërat që i solli më shumë humbje njerëzimit në çdo aspekt. Pati shumë humbje nga të dyja blloqet. Pati një goditje shumë të madhe në botë, sigurisht që këtu përfshihet edhe Shqipëria.

Një shtet si Shqipëria, edhe pse i vogël, mori pjesë në të dyja luftërat botërore. Mbase jo si një fuqi e madhe por si një komb patriot duke luftuar për dinjitetin e tyre. Përveç kësaj ne kemi mbrojtur dhe viktimë kësaj lufte, hebrenjtë, pasi ishin shumë të rrezikuar.

Shumë evente ndodhën të cilat morën jetë njerëzish. SS-ët transferuan në këtë kamp të burgosurit e parë, të cilët erdhën nga kampi i përqendrimit Dachau, kjo ndodhi më 8 gusht 1938. Pati shumë sfida për të burgosurit. Uria, puna sfilitëse dhe dhuna karakterizonte jetën e përditshme të të burgosurve. Brenda 18 muajve të parë të ndërtimit të këtij kampi vdiqën rreth 500 të burgosur.

Këtë të burgosur ndaheshin në disa kategori. Kategoria I: në kampet e kësaj kategorie mbaheshin të burgosurit që konsideroheshin të aftë për t'u përmirësuar me kusht si edhe të burgosur të rëndësishëm. Kampet e përqendrimit Dachau , Sachsenhausen dhe kampi kryesor në Auschwitz-Birkenau hynin në këtë kategori. Kategoria II: Në kampet e përqendrimit të kategorisë II, mbaheshin të burgosurit që konsideroheshin të aftë për riedukim dhe korrigjim të sjelljes. Në këtë kategori bënin pjesë kampet e përqendrimit Buchenwald , Flossenbürg , Neuengamme dhe Auschwitz-Birkenau. Kategoria III: I vetmi kamp përqendrimi që bënte pjesë në këtë kategori ishte kampi i përqendrimit Mauthausen dhe nënkampi i tij, Gusen. Në këto kampe deportoheshin të burgosurit që konsideroheshin si të pakorrigjueshëm e që vështirë se mund të

përmirësosheshin. Numri i të burgosurve në kampin e përqendrimit Mauthausen në fund të vitit 1943 ishte rreth 25.000. Ky numër nuk përfshin ata që vdiqën, u vranë ose u transferuan në kapmë të tjera.

Ndëshkimet bëheshin shpesh dhe kjo solli shumë pasoja. Më pas kemi dhe kushtet çnjerëzore ku ata jetonin. Një nga ndëshkimet e zakonshme ishte varja, e cila bëhej në tingujt e muzikës në sheshin e madh të apelit. Të internuarit ishin të detyruar të shikonin shokët e tyre teksa i varnin publikisht. Varja bëhej me një pajisje të madhe që ngrinte 9-11 vetë njëherësh. Kur ishte ftohtë, të linin jashtë 24 orë, dhe ishte i vdekur. Dhe ky ishte një dënim. Kohët e fundit gjermanët tërboheshin dhe nga emri i shqiptarëve. Sa dëgjonin që ishim shqiptarë, na rrihnin kot atë kohë. Ne nuk e dinim arsyen, por e morëm vesh më vonë se në 29 nëntor 44 Shqipëria ishte çliruar nga partizanët, dhe gjermanet ishin tërhequr nga ky vend. Por fatkeqësisht me çlirimin e Shqipërisë, nuk erdhi dhe çlirimi ynë. Ne e ndjenim se ndërsa gjermanëve laku u ngushtohej nga dita në ditë, ata u bënë edhe më të egër ndaj nesh, pasi humbjet andej po ua shkarkonin të burgosurve. Nga çlirimi i Shqipërisë deri në 9 maj 1945 që mori fund lufta, aty u vranë, u helmuan dhe dogjën qindra e mijëra njerëz të tjerë. Në shkurt 1945 pas shumë torturash vdiq dhe Kozma Nushi, i cili ishte dhe udhëheqësi i rezistencës shqiptare në Kampin e Zemunit dhe të Banicës, si dhe të Mauthausen-it. Një nga dënimet e kampit ishte dushi. Këtu dënimet jepeshin nga personeli i bllokut. Nëse dikush nuk i pëlqente personelit, atëherë ai futej në dush dhe qëndronte aq gjatë sa binte në tokë. Në banjë kanë vdekur shumë vetë.

Shmë krime u kryen edhe ndaj hebrenjve të cilët u përhapën nëpër shqipëri. Gjithsesi qëndrat ishi Tirane dhe Durrës. Në fillim ishin 200 dhe në fund të luftës ishin rreth 1800. Ne nuk treguam asnjëherë dhe i pranuan në rrethin tonë.

Më vonë, Në prill 1945, me afrimin e trupave aleate, SS-ët filluan të shkatërronte gjurmët e krimeve që kishin kryer. Ata çmontuan objektet për vrasjet masive, zhdukën provat inkriminuese dhe vranë të burgosurit e kampit të përqendrimit, të cilët kishin qenë dëshmitarë të drejtpërdrejtë të vrasjes masive sistematike, me qëllim zhdukjen e dëshmitarëve të krimeve të tyre

Siç thashë, kjo luftë solli një dëm shumë të madh për botën, por akoma më të madh për një shtet të vogël, pa qeveri dhe që në kongrese ishte thjesht një objekt gjeografik asnjëherë i përmëndur për rregullim por vetëm për shkatërrim dhe humbje autoriteti. Prap së prapi ne arritëm edhe me hapa të vegjël të zhvillohemi.

Punoi : Virginia Taçi

Ismail Qemali